

# *Raport i vëzhgimit*

Zgjedhjet e Përgjithshme 2014

## Zgjedhje të jashtëzakonshme me sfida të zakonshme

**Prishtinë**

**Gusht, 2014**

Copyright ©2014. Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), si dhe Ambasadës së Norvegjisë në Kosovë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorëve.

# Përmbajtja

<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
Metodologjia	6
<b>I. Korniza ligjore</b>	<b>7</b>
Legjislacioni Primar	7
Sistemi zgjedhor	7
Legjislacioni sekondar	8
<b>II. Përgatitjet për Zgjedhje</b>	<b>9</b>
Shpallja e zgjedhjeve	9
Puna e KQZ-së	9
Funksionimi i KKZ-ve	11
Trajnimi i KVV-ve	11
Edukimi votues	11
<b>III. Vlerësimi i fushatës elektorale</b>	<b>12</b>
Përdorimi i burimeve shtetërore	12
Bojkoti i subjekteve politike serbe	14
Prezenca e fëmijëve dhe përfaqësimi gjinor	14
<b>IV. Niveli i informimit të votuesve</b>	<b>15</b>
<b>V. Përbërja e KVV-ve</b>	<b>16</b>
<b>VI. Procesi i votimit</b>	<b>17</b>
Hapja e vendvotimeve	17
<i>Prania e materialeve propaganduese</i>	18
<i>Materiali sensitiv</i>	19
Fshehtësia e votës	20
<i>Votimi familjar</i>	20
<i>Votimi me asistencë</i>	22
<i>Fotografimi i fletëvotimeve</i>	23
Incidentet në procesin zgjedhor	24
Sfidat e administrimit	26
<i>Personat e vdekur në Listë</i>	26
<i>Përpjekjet për votim të dyfishtë</i>	26

Ankesat zgjedhore	27
<b>VII. Procesi i numërimit</b>	<b>29</b>
<i>Periudha e numërimit të votave</i>	29
<i>Pritjet në radhë</i>	30
<i>Mospajtimet gjatë numërimit</i>	31
<b>VIII. Dalja në votime</b>	<b>32</b>
Votat e pavlefshme	33
<b>IX. Rekomandimet</b>	<b>35</b>
A. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	35
B. Komisionet Komunale Zgjedhore	36
C. Këshillat e Vendvotimeve	36
D. Subjektet politike	36
E. Mekanizmat e ankesave	37
F. Kuvendi i Kosovës	37

## Hyrje

Njësoj sikurse zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të viti 2010, edhe ato të përgjithshmet ishin të parakohshme, pasi që Kuvendi i Kosovës u shpërbë pa e përfunduar mandatin e tij të katërt.

Këto zgjedhje të parakohshme imponuan afatin e shkurtër të organizimit të zgjedhjeve. Megjithatë, është evidente që zgjedhjet e përgjithshme të 8 qershorit 2014, i janë përmbajtur standardeve të zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Sidoqoftë, të dhënat që do të prezantohen në këtë raport tregojnë se procesi zgjedhor në Kosovë ka ngecje në disa fusha, ndaj mbetet mjaft punë për t`u përmirësuar dhe avancuar.

Demokracia në Veprim përmes misionit vëzhgues të zgjedhjeve sjell raportet që synojnë të paraqesin rrjedhën e procesit zgjedhor në mënyrë që ngecjet e mundshme të mund të evitohen apo të përmirësohen.

Për gati tri vite, subjektet politike punuan në reformën zgjedhore, por nuk arritën pajtim për çështjet kryesore të reformës. Ky veprim shkaktoi bllokadë të tërësishme të procesit. Në draft-amendamentet për ligjin e zgjedhjeve të përgatitur nga komisioni parlamentar për reformë zgjedhore, u miratuan kryesisht ndryshime të vogla anësore dhe nuk u prekën problemet kyçe të sistemit zgjedhor. Të dhënat, të cilat i prezanton ky raport, tregojnë se shumë nga këto probleme mund të evitohen nga niveli teknik i organizimit të zgjedhjeve. Kjo mund të arrihet përmes trajnimeve më cilësore të komisionarëve, bashkëpunimit më të ngushtë me shoqërinë civile, informimit të votuesve në mënyrë më të përqendruar, apo auditimeve të fletëvotimeve dhe materialit sensitiv pas përfundimit të procesit zgjedhor.

Sfidat kryesore që dalin nga ky proces zgjedhor janë:

- votat e pavlefshme
- informimi i votuesve për vendvotimin e tyre
- lejimi i propagandës politike në disa lokalitete brenda qendrës së votimit dhe brenda diametrit 100 metra të qendrës
- prezenca e personave të vdekur në listë të votuesve (edhe pse në masë më të vogël se zgjedhjet e kaluara)
- fshehtësia e votës (përmes votimit familjar, fotografimit të votës dhe votimit jashtë kabinës)
- mosregjistrimi i votimeve me asistencë dhe rënia e ndjeshme e daljes në votime në disa komuna.

Ulja e përqindjes së daljes në votime është më e madhja nga viti 2007. Prandaj, mbetet shqetësues ky nivel i daljes në zgjedhje, ndonëse u mbajtën në pranverë dhe në kushte të përshtatshme klimatike.

Nga ana tjetër numri i madh i votave të pavlefshme, i cili është pothuajse i njëjtë me zgjedhjet e 2010-s, mbetet sfida për procesin zgjedhor në Kosovë dhe kërkon vëmendje serioze të KQZ-së, si dhe bashkëpunim më të ngushtë me shoqërinë civile dhe subjektet politike.

Nga 1899 sa ishin votat e dëmtuara në zgjedhjet lokale, ato u dyfishuan në zgjedhjet e parlamentare. Në disa komuna, si ajo e Ferzajt, ka një dhjetëfishim të votave të dëmtuara, gjë e cila përbën shqetësim për Demokracinë në Veprim.

Zgjedhjet e parakohshme imponuan afat të shkurtër për organizmin e tyre. Kësisoj, për rreth një muaj u bë fushata për edukim të votuesve, fushata zgjedhore 10 ditore, si dhe trajnimi i mijëra komisionarëve dhe vëzhguesve.

Fushata zgjedhore ishte kryesisht e qetë, megjithëse është vërejtur pjesëmarrje e shërbyesve civil dhe punëtorëve shëndetësor e arsimor në të gjatë orarit të punës.

Poashtu, automjetet zyrtare kanë vazhduar të përdoren nga kandidatët për të tërhequr votues gjatë fushatës zgjedhore.

Kosova deri tashti ka mbajtur nëntë palë zgjedhje, katër nga të cilat i ka organizuar vetë, pa ndihmën ndërkombëtare. Prandaj, zyrtarët e zgjedhur, administratorët zgjedhor, subjektet politike si dhe shoqëria civile duhet të marrin mësim nga përvoja e zgjedhjeve të deritashme dhe të ecin përpara me përgatitje më të madhe për përmirësimin e procesit zgjedhor. Ky raport është një bazë e mirë për të bërë pikërisht këtë.

## Metodologjia

Qëllimi i Demokracisë në Veprim është arritja e standardeve më të larta demokratike në procesin zgjedhor në Kosovë, si dhe promovimi i zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të barabarta. Sikurse në zgjedhjet paraprake, me shpalljen e zgjedhjeve nga presidentja e vendit, Demokracia në Veprim mobilizoi rrjetin e organizatave dhe vullnetarëve për t'u përfshirë në procesin parazgjedhor, ditën e zgjedhjeve dhe procesin paszgjedhor. Aktivitet bazë i DnV-së, ka qenë edukimi i votuesve, vëzhgimi i fushatës zgjedhore, monitorimi i procesit të votimit dhe numërimit, si dhe përcjellja e vendimeve të PZAP-së në trajtimin e ankesave dhe parashtrësive.

Demokracia në Veprim, ka monitoruar fushatën 10 ditore të zgjedhjeve të jashtëzakonshme të mbajtura me datën 8 qershor 2014. Në këtë fushatë ka angazhuar 60 vëzhgues afatgjatë për të mbuluar të gjithë aktivitetet partiake në gjithë Kosovën. Të gjeturat nga monitorimi i fushatës janë publikuar nga DnV-ja vazhdimisht gjatë fushatës zgjedhore, përmes konferencave dhe komunikatave për shtyp. Në to, ndër të tjera, subjekteve politike u është bërë thirrje që të respektojnë Kodin e Mirësjelljes.

Procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve është monitoruar nga 2.400 vëzhgues të angazhuar nga DnV-ja, përmes rrjetit të saj të organizatave në tërë Kosovën, përfshirë edhe komunat e veriut. Në këtë proces zgjedhor Demokracia në Veprim ka mbuluar secilin nga 2,377 vendvotimet e Kosovës dhe ka pasur disa ekiye mobile.

Secili nga vëzhguesit është trajnuar për legjislacionin zgjedhor, vëzhgimin e procesit të votimit, numërimin, plotësimin e drejtë të formularëve dhe mënyrën e raportimit në Qendrën e Thirrjeve të krijuar nga DnV-ja. Shumica e informatave të prezantuara në këtë raport burojnë nga të dhënat e grumbulluara nga vëzhguesit ditor.

Në ditën e zgjedhjeve, DnV-ja, ka krijuar Qendrën e Thirrjeve, me rreth 150 vullnetarë të angazhuar, të cilët në mënyrë sistematike gjatë ditës kanë komunikuar me vëzhguesit në vendvotime. Vullnetarët kanë marrë informata për daljen e votuesve, procesin e votimit, apo parregullsitë eventuale që kanë kërkuar vëmendjen e duhur të autoriteteve. Pasi që të gjitha të dhënat e vëzhguesve janë futur në bazën e të dhënave, ato janë analizuar dhe është përgatitur ky raport, i cili synon paraqitjen e një pasqyre të përgjithshme të zgjedhjeve, organizimit, mbajtjes dhe certifikimit të tyre.

## I. Korniza ligjore

### Legjislacioni Primar

Zgjedhjet e 8 qershorit 2014 erdhën si rezultat i vendimit të Kuvendit të Kosovës për vetë-shpërndarje. Ato u organizuan dhe u zhvilluan në bazë të nenit 66 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit nr.03/1-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të plotësuar dhe ndryshuar në tetor të vitit 2010. Duhet theksuar se edhe këto zgjedhje u organizuan me sistemin e vjetër zgjedhor, meqë subjektet politike nuk arritën marrëveshje për ta ndryshuar legjislacionin zgjedhor, edhe pse këtë proces e kishin filluar në prill të vitit 2011, pas miratimit të Rezolutës në Kuvendin e Kosovës.

Zonat zgjedhore, sistemi zgjedhor, përbërja e KQZ-së, apo pragu zgjedhor ishin ndër temat, të cilat nuk morën konsensusin e lidërshiptit të subjekteve politike. Përpyekja e fundit e Kuvendit për miratimin e projektligjit me ndryshime më shumë të karakterit teknik. Komisioni Ad hoc nuk arriti t'i fusë në fuqi ndryshimet, si rezultat i vendimit të Kuvendit për vetë-shpërndarje dhe shkuarje të vendit në zgjedhje të parakohshme.

### Sistemi zgjedhor

Me ligjin aktual në fuqi, Kosova është një zonë zgjedhore. Deputetët e Kuvendit zgjedhen sipas sistemit proporcional me lista të hapura në kombinim me votimin preferencial për kandidatët e subjekteve politike.

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme ka përcaktuar se: votuesi pajiset me një fletëvotim të vetëm për zgjedhje dhe voton duke shenjuar një subjekt politik.

Votuesi, gjithashtu mund të rrumbullakojë deri në pesë kandidatë nga lista e subjektit politik të preferuar.

Nëse në një fletëvotim shenjohen më shumë se pesë kandidatë, atëherë numërohet vetëm vota e hedhur për subjektin politik.

Sipas Kushtetutës së Kosovës, Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura. Vendet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur, në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre, në zgjedhjet për Kuvend.

## Legjislacioni sekondar

Legjislacioni sekondar ka një rëndësi të veçantë në zbatimin e mandatit të KQZ-së si institucion kushtetues që përgatitë, mbikëqyrë, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet, që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor.

KQZ-ja edhe në këtë fazë ka miratuar disa akte normative, të cilat hynë në funksion të plotësimit të kuadrit ligjor, lehtësimin e ushtrimit të mandatit nga ana e KQZ-së. Ky institucion edhe në vitet paraprake ka miratuar një numër të madh të akteve sekondare si rregulla zgjedhore dhe udhëzime administrative, të cilat janë aplikuar edhe në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 8 qershorit 2014. Forma më e shprehur e artikulimit normativ në këto zgjedhje ka qenë përmes vendimeve që KQZ-ja i ka marrë me qëllim të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Vetëm për këtë proces KQZ-ja ka marrë rreth 46 vendime që nisin nga vendimi për miratimin e Doracakut të Trajnimit për Procedurat e Votimit dhe Numërimit në Vendvotim për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të miratuar me 12.05.2014, e deri tek Vendimi për certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të 8 qershorit 2014.

Edhe në këtë proces zgjedhor, KQZ-ja me qëllim të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor ka nënshkruar disa memorandume me institucione të rëndësishme në mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor. Memorandumet janë nënshkruar me: Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Drejtësisë, BE-në, Këshillin Gjyqësorë, Prokurorin e shtetit, policinë e Kosovës si dhe me Panelin Zgjedhor për Ankesa e Parashtresa.



## II. Përgatitjet për Zgjedhje

### Shpallja e zgjedhjeve

Skena politike e vendit është përbërur me një situatë jo të zakonshme për një periudhë relativisht të gjatë. Qeveria nuk e ka pasur shumicën në Kuvend për të aprovuar legjislacionin apo vendimet që kërkonin shumicën absolute, e nga ana tjetër opozita në Kuvend nuk i kishte numrat për të kërkuar rrëzimin e qeverisë. Në këtë kontekst, ka ekzistuar një pajtim te faktori politik kosovar se me një situatë të tillë nuk mund të funksiononte vendi, ndaj u shtrua si çështje imediate mbajtja e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Komisionit *Ad hoc*, i krijuar për reformë zgjedhore i skadoi mandati pa arritur qëllimin për të cilin ishte themeluar. Nga ana tjetër liderët e partive politike nuk demonstuan vullnet të duhur politik për reformë zgjedhore. Kjo çështje u riaktualizua përsëri në fund të janarit 2014, kur Kuvendi i Kosovës mori vendim që këtë çështje t'ia kalojë Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Sikurse edhe komisioni paraprak- *Ad hoc*, as ky komision nuk arriti të përfundojë punën e vetë, ngase puna e tij nuk u votua asnjëherë në Kuvendin e Kosovës. Edhe pse reforma në esencë ishte kozmetike, ngase anashkaloi zonat zgjedhore, listat, apo përbërjen e KQZ-së, dështoi, duke fokusuar debatin në çështjen e vendeve të rezervuara dhe atë të ligjit për Forcat e Armatosura.

Pas një serie bisedimesh në mes të liderëve të partive politike (përjashto Lëvizjen Vetëvendosje që nuk ishte e ftuar në këto takime), u arrit marrëveshja që Kuvendi i Kosovës të shpërndahet me datën 7 maj 2014. Me 90 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime, deputetët vendosën që ta shpërndajnë Kuvendin e Kosovës. Një ditë më vonë, presidentja e vendit, pas konsultimeve me partitë politike dhe aktorë të tjerë, shpalli 8 qershorin, datë për mbajtjen e zgjedhjeve parlamentare të parakohshme. Në këtë mënyrë, topi u hedh tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili ka mandatin kushtetues për organizimin e zgjedhjeve.

### Puna e KQZ-së

Për dallim nga zgjedhjet lokale të vitit 2013, kur KQZ-ja u përball me organizimin e zgjedhjeve në veri dhe përmbajtjen e fletëvotimeve, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës, ky institucion nuk e pati një presion të tillë. Simbolet shtetërore u kthyen në fletëvotime, OSBE-ja, sërish mori përsipër organizimin e zgjedhjeve në komunat e veriut, pa bujë.


Megjithëse vendi ecte drejt zgjedhjeve të parakohshme, KQZ-ja mbeti peng i reformës zgjedhore, e cila pritej të miratohej në Kuvend. Ndaj KQZ-ja e pati të pamundshme të zhvillojë aktivitete që lidhen me mbajtjen e zgjedhjeve.

Kur presidentja caktoi 8 qershorin për mbajtjen e zgjedhjeve, KQZ-ja, pati në dispozicion një afat prej një muaji për organizimin e zgjedhjeve. Koha e shkurtër në dispozicion për organizim të zgjedhjeve ka shqetësuar edhe kryetaren e KQZ-

së, znj. Valdete Daka, e cila periudhën e shkurtër e ka cilësuar sfiduese<sup>1</sup>. Megjithatë, edhe përkundër afatit shumë të shkurtër, KQZ u takua shumë rrallë gjatë kësaj periudhe. Organizimi dhe menaxhimi i zgjedhjeve në Kosovë ballafaqohet me mjaft sfida, andaj KQZ do duhej të kishte takime më të shpeshta sidomos pasi koha e organizimit ishte e shkurtër.

Nga data 12 maj 2014 deri me datën 5 qershor 2014, KQZ-ja, mbajti 12 takime. Në takimin e 27 majit, mori një vendim kontradiktor që ndalonte publikimin e posterave promovues. Ky vendim i KQZ-së ra ndesh me nenin 44 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Me vendim, u ndalua vetëm një format i caktuar i posterëve, teksa një gjë e tillë u vendos një ditë para fillimit të fushatës, kur subjektet politike i kishin posterët e gatshëm.

Por, apeli i një subjekti politik, bëri që PZAP<sup>2</sup>-ja ta anuloi vendimin e KQZ-së. Përveç këtij vendimi, në një rën nga mbledhjet e mbajtura të KQZ-së, anëtarët e këtij institucioni kanë kërkuar nga Sekretariati i KQZ-së që të shqyrtojë mundësitë e numërimit të votave (sidomos të atyre për kandidatë) në qendra komunale, ndonëse Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e specifikon qartë se votat numërohen vetëm në vendvotim. Sidoqoftë, një vendim i tillë asnjëherë nuk u hodh për votim në KQZ.



<sup>1</sup> Telegrafi. 03 maj 2014. Daka: Zgjedhjet më 08 qershor, opSION i pamundur. Gjetet në: <http://www.telegrafi.com/lajme/daka-zgjedhjet-me-8-qershor-opSION-i-pamundur-2-44270.html>

<sup>2</sup> Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). 29 maj 2014. Vendimi A. nr. 79/2014. Gjetet në: <http://pzap.rks-gov.net/repository/docs/Anr%2079%20Vendim.pdf>

## Funksionimi i KKZ-ve

Funksionimi i mirëfilltë i Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), vazhdon të mbetet një nga sfidat kryesore të menaxhimit të procesit zgjedhor. Sikurse në zgjedhjet paraprake, edhe në këto zgjedhje vëzhguesit afatgjatë të Demokracisë në Veprim, kanë vërejtur mangësi të shumta në funksionimin e KKZ-ve. Natyrisht, jo të gjitha KKZ-të kanë pasur problemet e njëjta, pra disa kanë funksionuar në nivel relativisht të kënaqshëm, teksa të tjerat nuk kanë mbajtur pothuajse asnjëherë takime të rregullta. Kjo tregon se nuk ka pasur një mbikëqyrje të duhur nga ana e SKQZ-së, ndaj funksionimi i KKZ-ve më shumë ka funksionuar nga vullneti i Zyrtarit Komunal Zgjedhor. Ndër mangësitë kryesore në funksionimin e KKZ-ve, vazhdojnë të mbesin takimet jo të rregullta, mungesa e procesverbaleve, dokumenteve të tjera informuese si dhe pasiviteti i disa zyrtarëve komunal zgjedhor.

## Trajnimi i KVV-ve

Sikurse në zgjedhjet e kaluara edhe në këto zgjedhje, Demokracia në Veprim i ka kushtuar rëndësi të veçantë monitorimit të trajnimeve të komisionerëve zgjedhor. Vëzhguesit afatgjatë të Demokracisë në Veprim kanë monitoruar një numër të konsiderueshëm të trajnimeve të zyrtarëve të KVV-ve. Sfidë në vete për monitorimin e trajnimeve ka qenë mungesa e orarit të trajnimeve, gjë që ka ndodhur në shumë komuna.

Nga trajnimet e monitoruara nga vëzhguesit e DnV-së, në krahasim me zgjedhjet e kaluara, është vërejtur një seriozitet më i madh si në organizim, po ashtu edhe në pjesëmarrje të komisionerëve të partive në trajnime. Megjithatë, ende ka shumë punë që të bëhet, si në aspektin e trajnimit të komisionerëve, po ashtu edhe në rritjen e cilësisë së vetë komisionerëve. Natyrisht që në këtë aspekt duhet një angazhim i të gjithë akterëve, e sidomos partive politike të cilat janë ato që nominojnë anëtarët e tyre në KVV.

## Edukimi i votuesve

Edukimi i votuesve në vazhdimësi është vlerësuar si një nga pikat më të dobëta të KQZ-së. Në zgjedhjet e vitit 2013, KQZ-ja, është akuzuar se ka organizuar një fushatë shumë të dobët të informimit. Duke ndjerë përgjegjësinë e dështimit të informimit publik në zgjedhjet paraprake lokale, si dhe duke pasur parasysht kohën e shkurtër në dispozicion, KQZ-ja, ka vendosur që operatorin për informim të votuesve ta zgjedhë përmes tenderit të negociuar. Për këtë vendim të KQZ-së, ka pasur një ankesë nga njëra nga kompanitë që është përjashtuar nga tenderi dhe si pasojë OSHP-ja, ka pezulluar për tri ditë aktivitetet informuese të KQZ-së.

Pezullimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese për votuesit, natyrisht ka ndikim të madh. Sidoqoftë, përkundër kohës së shkurtër në dispozicion, disa nga produktet e edukimit dhe informimit të votuesve, kanë qenë të një kualiteti më të mirë sesa në zgjedhjet e kaluara.

Por, numri i madh i votave të pavlefshme edhe në këto zgjedhje, tregon për efikasitetin e vogël të kësaj fushate. Kjo tregon se KQZ-ja, duhet të zhvillojë një program të mirëfilltë të edukimit të votuesve, i hartuar dhe bazuar në nevojat e votuesve, si dhe i ndarë në disa kategori të votuesve.

### III. Vlerësimi i fushatës elektorale

Bazuar në autorizimet ligjore të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme si dhe bazuar në Rregullën Zgjedhore të KQZ-së me nr. 15/2013, për zgjedhjet e jashtëzakonshme, si dhe për zgjedhjet e parakohshme, KQZ-ja ka marrë vendim që fushata zgjedhore të shkurtohet në vetëm dhjetë (10) ditë. Pra, të fillonte më 28 maj 2014 dhe të mbyllet më 6 qershor.

Sipas të dhënave të monitoruesve të koalicionit të OJQ-ve “Demokracia në Veprim”, të cilët kanë monitoruar një numër të madh të tubimeve publike të subjekteve politike, fushata elektorale është vlerësuar e qetë, civile dhe pa incidente.

Në kontekstin e rrjedhës së fushatës elektorale, KQZ-ja një ditë para fillimit zyrtar të fushatës elektorale, mori një vendim kontravers, me të cilin ndaloi publikimin e posterave promovues të madhësisë B2. Ky vendim u ankimua menjëherë nga subjektet politike në PZAP, ndaj i fundit e anuloi vendimin e KQZ-së. Pavarësisht qëllimit konstruktiv, të cilin e pretendonte KQZ-ja, DnV-ja vlerëson se ky institucion nuk është organ ligjvënës dhe nuk ka të drejtë të nxjerrë akte të cilat bien në kundërshtim me Ligjin bazik – atë për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Gjithashtu problem për mediat dhe OJQ-të monitoruese ka paraqitur mos lajmërimi i aktiviteteve të subjekteve politike në KKZ. Mediat dhe shoqëria civile në shumë raste kanë qenë konfuz rreth agjendave të partive, ngase edhe kur ato lajmëroheshin në KKZ, nuk përputheshin me aktivitetet e paralajmëruara.


### Përdorimi i burimeve shtetërore

Edhe në këtë fushatë elektorale janë evidentuar shumë raste të shfrytëzimit të resurseve publike për qëllime elektorale nga ana e subjekteve politike, megjithëse veprimet e tilla janë të ndaluara me Kodin e Mirësjelljes së Subjekteve Politike.

Neni 5 i Kodit të Mirësjelljes thotë: *“Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me*

qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”.


## AUTOMJETET PUBLIKE NË FUSHATË



Pavarësisht kësaj dispozite, vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar 41 raste të përdorimit të resurseve publike për qëllime elektorale. Veturat zyrtare janë hasur gjatë aktiviteteve parazgjedhore kryesisht nga subjektet politike në pushtet. Nga 41 rastet e raportuara, në 15 është përfshirë PDK-ja apo 36.5% , në 9 raste, AKR-ja, në 7, LDK-ja si dhe në 6, AAK-ja.

Vërejtje të shumta janë paraqitur jo vetëm nga monitoruesit, por edhe nga subjektet politike, kryesisht opozitare në lidhje me shfrytëzimin e punëtorëve të administratës së komunës, mjekëve si dhe të arsimtarëve në aktivitetet elektorale. Në Mitrovicë e Gjakovë, janë evidentuar dy raste ku për shkak të fushatës është ndërprerë puna e spitaleve. Në Mitrovicë për shkak të aktiviteteve elektorale të kryetarit të PDK-së Hashim Thaçi, udhëheqësit e spitalit kanë urdhëruar pezullimin e punës në këtë institucion shëndetësor. Kurse në Gjakovë, sërish gjatë vizitës që Thaçi i ka bërë spitalit, është ndërprerë puna e këtij institucioni.

## SHFRYTËZIMI I SHËRBYESVE CIVIL



## Bojkoti i subjekteve politike serbe

Qysh në fillim të fushatës elektorale, krerët e katër komunave të pjesës veriore të Kosovës paralajmëruan se do të heqin dorë nga aktivitetet e lidhura me zgjedhjet e 8 qershorit. Nga ana tjetër Komisioni i Zgjedhjeve ka miratuar kërkesën e tyre për eliminimin e simboleve të Kosovës nga fletëvotimet dhe që përfaqësuesit serbë të bëhen pjesë e këshillave të vendotimeve në pjesën jugore të Kosovës.


Kjo edhe u materializua në praktikë ngaqë nuk u evidentua asnjë aktivitet publik në këtë pjesë të Kosovës. Nga ana tjetër e njëjta gjë nuk ndodhi edhe në pjesën jugore të vendit në komunat me shumicë serbe, ku subjektet politike kishin hapur shtabet zgjedhore dhe kishin realizuar aktivitete elektorale.

## Prezenca e fëmijëve dhe përfaqësimi gjinor

Raste të përdorimit të fëmijëve në aktivitetet dhe tubimet elektorale, janë bërë praktika të shpeshta nga shumica e subjekteve politike. Pjesëmarrja në tubime, si dhe shpërndarja e posterëve të subjekteve politike nëpër rrugë, kanë qenë disa nga format e evidentuara të përdorimit të fëmijëve në fushatë.

Pjesëmarrja e grave në fushata elektorale të subjekteve politike, vazhdon të mbetet në nivelin simbolik. Nga të gjitha aktivitetet e monitoruara nga vëzhguesit e DnV-së, në shumicën prej tyre pjesëmarrja e grave ka qenë nën 5%.

### PJESËMARRJA E GRAVE NË FUSHATË




## IV. Niveli i informimit të votuesve

Gjatë procesit të votimit është evidentuar sërish i njëjti problem sikurse në zgjedhjet e kaluara, kur votuesit janë kthyer mbrapsht, ngase nuk kanë pasur të drejtë vote në qendrën ku janë paraqitur.

Votuesit i caktohet qendra e votimit përmes një sistemi të koduar (kodi-P për zonat më rurale dhe kodi-UD për zonat urbane), që jepet nga Ministria e Punëve të Brendshme në momentin e lëshimit të dokumentit personal/letërnjoftimit. Mungesa e një sistemi të kodifikuar të adresave është pjesërisht përgjegjëse për vendosjen e gabueshme të votuesve në qendrave të votimit më të afërta. Një auditim që i është bërë Ekstraktit të Regjistrimit Civil gjatë përgatitjeve për zgjedhjet e vitit 2010, e që është realizuar nga IFES-i, përmes një hulumtimi ka treguar arsye të ndryshme pse 40% e qytetarëve nuk i posedojnë adresat e evidentuara në ekstrakt<sup>3</sup>.

Një anketë që Demokracia në Veprim ka bërë në prag të zgjedhjeve lokale më 2013, ka treguar se 1 në 10 votues nuk kanë qenë të sigurt se ku është qendra e tyre e votimit. Shpërndarja e këtyre votuesve ka qenë gati e barabartë për qytetarët e zonave urbane dhe atyre rurale. Në zonat urbane kjo është vërejtur më shumë, ngase në ato rurale, në shumicën e rasteve është vetëm një qendër e votimit në afërsi. Më shumë se 13% e votuesve që kanë votuar për herë të parë (mosha 18-24) nuk e kanë ditur qendrën e tyre të votimit, dhe kjo kryesisht ka ndodhur për shkak se nuk kanë votuar më herët, ndaj rrjedhimisht nuk e kanë ditur qendrën e tyre.

Edhe në këto zgjedhje të përgjithshme me afate të zgjedhjeve të jashtëzakonshme kishte një numër të konsiderueshëm të votuesve që u kthyen prapa nga qendrat e votimeve për shkak të mosinformimit të vendvotimit të tyre. Vëzhguesit e DnV-së raportuan gjithsej 9,055 votues të kthyer prapa për shkak të ngatërimit të vendvotimit, dhe faktit që nuk e kishin gjetur vetën në listën e votuesve aty ku shkuan të votojnë. Megjithatë, kjo shifër është me e ulët sesa 17,000 votues që u raportuan ta kenë ngatërruar vendvotimin në zgjedhjet lokale të vitit 2013.



<sup>3</sup> IFES. Janar 2011. Vlerësimi i Ekstraktit të Regjistrimit Civil, Tetor 2010. Shkruar nga Lauren Serpe.

Rastet më të shumta ku u raportuan probleme në vendvotimit janë: Prizren (1,296 votues), Prishtinë (1,102 votues), Skenderaj (745 votues), Pejë (573 votues) dhe Mitrovicë (555 votues).

Kjo situatë, për të cilën KQZ-ja duhet të angazhohet më shumë për ta përmirësuar ka për pasojë një numër të lartë të votave me kusht, si dhe ka shkaktuar konfuzion dhe irritim në ditën e zgjedhjeve, pastaj ka krijuar vështirësi në informimin e qytetarëve përmes sistemit postar dhe ka afektuar edhe daljen e votuesve në zgjedhje.

## V. Përbërja e KVV-ve


Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur që të këto zgjedhje të përgjithshme të organizohen në 2.377 vendvotime të vendosura në 798 qendra votimi, në 38 komuna të Kosovës. Këtë radhë, pati 2 qendra të votimit më shumë në krahasim me zgjedhjet lokale të vitit 2013 dhe 60 më shumë se zgjedhjet e fundit të përgjithshme të vitit 2010.

Për administrimin e 2,377 vendvotimeve, KQZ-ja, akreditoi më shumë se 17 mijë komisionerë në vendvotime nga subjektet politike. Komisionerët janë caktuar nga subjektet politike sipas Nenit 74.1 të ligjit, i cili thotë se “përbërja e Këshillit të Vendvotimit (KVV) reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ-së”.

Numri i KKZ-ve përcaktohet me Nenin 67.1 të ligjit, i cili thotë se KKZ-ja në përgjithësi ka shtatë (7) anëtarë dhe ky numër mund të rritet.

KQZ-ja nuk e evideton në listën e komisionarëve të angazhuar përkatësinë gjinore, ndaj kjo tregon se nuk i kushtojnë kujdes të duhur përfaqësimit gjinor. Demokracia në Veprim ka nxjerrë këto të dhëna nga përpunimi i listës së komisionarëve. Përfaqësimi gjinor në Këshillat e Vendvotimeve kësaj radhe ka qenë mi i mirë se sa në zgjedhjet e kaluara të vitit 2013, megjithatë ende mbetet i ulët. Në zgjedhjet e fundit të përgjithshme, gratë përbënin 23.1% të të gjithë anëtarëve të KVV-ve, ndërsa vetëm 13.4% të kryesuesve të KVV-ve.

Në zgjedhjet lokale të 2013-së Demokracia në Veprim ka raportuar se përfaqësimi i grave në KVV ishte vetëm 17.5%, ndërsa 9.0% të grave ishin kryesuese të KVV-ve.







Komuna e Glllogocit (8 vendvotime me vonesë) dhe komuna e Gjilanit (me 7 vendvotime me vonesë).

Më shqetësues është fakti se në disa vendvotime, vonesat ishin më shumë se 30 minuta. Vonesa të tilla janë raportuar në 8 raste: një në Mitrovicë ku njëri nga vendvotimet u hap në ora 9:15, 4 raste në Prizren dhe 3 raste në Gjakovë.


### Prania e materialeve propaganduese

Sipas ligjit, çdo personi, votuesi, komisioneri apo anëtari të një subjekti politik i ndalohet që të bëjë fushatë apo të shfaqë çfarëdo material me qëllim të ndikimit tek votuesi, jo vetëm në vendvotime por gjithashtu edhe 100 metra brenda hapësirës së njëjtë<sup>4</sup>.

Për më tepër, çdo anëtar i KVV-së, pavarësisht nga përkatësia e partisë politike ose pikëpamja politike, vepron në mënyrë të paanshme<sup>5</sup>.

Në bazë të raporteve të vëzhguesve të DnV-së, në 2.7% të vendvotimeve të zgjedhjeve të 8 qershorit, 2014 u raportua propaganda politike brenda në vendvotim. Këtu paraqiten raste, si: lejimi i votuesit në vendvotim me bluzë me simbole të një subjekti politik, fletushka të një subjekti brenda vendvotimit, apo edhe promovim i një subjekti gojarisht përmes vëzhguesit apo komisionierit (më poshtë gjenden rastet konkrete dhe vendvotimet se ku kanë ndodhur).

Raportimi i rasteve me propagandë politike brenda vendvotimeve ishte më i ulët se sa në zgjedhjet lokale, kur 3.9% të vendvotimeve kishte njëloj veprimi që klasifikohet si propagandë politike brenda vendvotimeve.



<sup>4</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 36.1.

<sup>5</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 74.9.

Në 3.5% të të gjitha qendrave të votimit është raportuar lejimi i posterëve dhe billboardëve në brendi të diametrit prej 100 metra nga qendra e votimit. Kjo përqindje megjithëse e lartë, është më e ulët se në zgjedhjet lokale 2013 (rundi i parë i mbajtur më 3 nëntor), ku u raportua se në 4.5% të qendrave të votimit është zhvilluar propagandë politike.

Vëzhguesit e Demokracisë në Veprim raportuan se propagandë politike jashtë dhe brenda vendvotimeve ka pasur në komunat: Pejë, Shtime, Viti, Deçan, Istog dhe Gjakovë. Kjo propagandë, sipas vëzhguesve është zhvilluar në mënyra ta ndryshme. Në shkollën “*Lidhja e Pejës*”, në Pejë në vendvotimin 07D, vëzhguesi i njëres prej partive politike ndërhyri tek votuesit të cilët gjendeshin në vendvotim, teksa një votues ka hyrë në vendvotim me bluzë e cila identifikonte një subjekt politik. Në Shtime, në shkollën “*Emin Duraku*”, në vendvotimin 02R, në kabinën e votimit është gjetur një fletë propaganduese e një subjekti politik. Në shkollën “*Tre Dëshmorët*”, në Istog vendvotimin 01R, një votues ka insistuar që të lejohet të votojë me bexh të një subjekti politik. Kurse në Gjakovë në shkollën “*Fahri Hoxha*”, në vendvotimin 02D, një person ka dalë nga kabina e votimit për t`i treguar gruas së tij se kë duhet ta votoj.

Propaganda politike në oborret e shkollave ku gjendeshin vendvotimet është bërë nga individë të cilët kanë qëndruar në hyrje të objekteve shkollore, duke sugjeruar subjektet apo kandidatët që duhet votuar.

Në Shtërpçë, në shkollën “*Staja Markoviq*”, në vendvotimin 01R, një person në korridor dhe në oborrin e shkollës ka ushtruar presion tek votuesit për të votuar një subjekt politik.

### Materiali sensitiv

Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve është se nuk ka pasur probleme të theksuara me materialin sensitiv, ku përfshihen: UV llampa, identifikimi i votuesve dhe sprej.

Në vendvotimet ku ka pasur probleme, janë evituar në një kohë afatshkurtër.

Megjithatë, janë evidentuar katër raste kur në vendvotime janë shfaqur probleme me UV llampa, identifikimin e votuesve (nuk është kontrolluar dokumenti identifikues) dhe një vendvotim ku është konfirmuar mosfunksionimi i spreit.

## MATERIALI SENSITIV



UV Ilamba

Dokumente Identifikimi

Sprej

Në Pejë në shkollën “Lidhja e Pejës”, në vendvotimin 07D, është raportuar se ka pasur probleme me UV llampë. Në Viti, në shkollën “*Kenan Halimi*”, në vendvotimin 02R, gjatë ditës është prishur dhe zëvendësuar llamba. Në Kaçanik, në shkollën “*Qamil Ilzai*”, në vendvotimin 02D, llampa është dëmtuar pas rënies në tokë dhe ka mbetur jashtë funksioni për 5 minuta. Më pas ajo u rregullua nga një komisioner.

Për dallim në zgjedhjet lokale të 2013-s, zgjedhjet e fundit, numri i llampave UV nuk ishte i mjaftueshëm apo ato konsideroheshin jofunksionale në 18 vendvotime në rundin e parë. Një situatë e tillë u pa edhe në 6 vendvotime në rundin e dytë të zgjedhjeve.

## Fshehtësia e votës

### Votimi familjar

Vota është fshehtë është e drejtë e garantuar me Kushtetutë. Por, sikurse edhe në zgjedhjet e deritashme, edhe në ato të fundit, nuk kanë munguar rastet e votimit familjar. Për këtë shkak, Demokracia në Veprim vazhdimisht ka bërë thirrje kundër kësaj forme votimi..

Edhe Rregulla Zgjedhore e KQZ-së 09/2013 e miratuar më 2 korrik 2013 në Nenin 15.4, specifikon se vetëm një person duhet të lejohet prapa kabinës, në çdo kohë, përveç rasteve kur votuesi ka nevoja të veçanta dhe kërkon ndihmë.

## VOTIMI FAMILJAR



Votimi familjar ndodh kur disa persona, me justifikimin e afërsisë familjare, votojnë në të njëjtën kabinë votimi. Si dukuri, është raportuar në 33.1% të vendvotimeve dhe është nivel të njëjtë me atë të raportuar në zgjedhjet lokale 2013 (rundi i parë).

Votimi familjar ndodh zakonisht kur një person i gjinisë mashkullore voton në kabinë në të njëjtë kohë kur voton personi i gjinisë femërore.

Megjithëse një formë e tillë veprimi perceptohet si ndihmë bashkëshortore, në fakt ajo cenon votën e lirë dhe votimin e fshehtë. Votimi familjar dallon nga “ndihma në votim”, si në rastin kur një personi i lejohet ligjërisht ta ndihmojë një votues që nuk di të lexojë apo ka pengesa në të pamur.

Votimi familjar nuk është i rregulluar nga KQZ-ja, porse komisionerët duhet të trajtohen më mirë për të parandaluar rastet e tilla dhe të cilat janë manifestuar edhe në këto zgjedhje.

Disa raste të votimit familjar të regjistruara nga vëzhguesit e DnV-së, janë evidentuar në disa komuna, si: Në Prizren në shkollën fillore “*Ibrahim Fetahu*”, në vendvotimin 01R, disa votues prej të njëjtës familje kanë udhëzuar njeri tjetrin në votim. Në shkollën fillore “*Idriz Seferi*”, vendvotimi 01R, janë evidentuar disa raste të votimit familjar. Në Fushë Kosovë, në shkollën “*Mihail Grameno*”, në vendvotimin 08R, ka qenë një rast kur bashkëshorti gjatë procesit të votimit ka ndërhy tek gruaja dhe i ka treguar se kë duhet të votoj ajo. Në Suharekë, në shkollat “*Migjeni*”, në vendvotimin 03d dhe “*Dëshmorët e Tivarit*”, në vendvotimin 02R, janë regjistruar disa raste të votimit familjar. Në Gjilan, në shkollën “*Selami Hallaqi*”, në vendvotimin 01R, gjatë votimit disa familjarë kanë komunikuar me njëri tjetrin, ndonëse ishin në kabina të

ndryshme. Në Mamushë, në shkollën “Haxhi Ymeri”, në vendvotimin 01R dhe 02R, po ashtu ka pasur një numër rastesh të votimit familjar. Në Malishevë, në shkollën “Salih Bytyqi”, në vendvotimin 02D, ka pasur raste kur bashkëshorti ka ndihmuar bashkëshorten të votojë. Në Gjakovë, në objektin e ri të shkollës “Mustafa Bakija”, në vendvotimin 07R, ka pasur tentim votimi familjar, mirëpo një veprim i tillë është kundërshtuar nga komisionarët që gjendeshin në vendvotim.



Gjatë procesit, janë evidentuar 50 raste, kur votuesit kanë hedhur votën jashtë kabinës. Në njërin rast, në shkollën fillore “Idriz Seferi”, në Kaçanik, në vendvotimin 01D, një person ka votuar jashtë kabinës. Megjithë reagimin e kryesuesit të komisionit zgjedhor, personi ka vazhduar votimin jashtë kabinës. Në vendvotimin 1913e/10d në Prishtinë (Fakulteti Ekonomik-Juridik), është shënuar një rast kur votuesit nuk iu siguria fshehtësia e votimit.

### Votimi me asistencë

Dyshimet për parregullsitë më të mëdha ndodhin tek votimi me asistencë. Kjo mënyrë e votimit, e dedikuar për të ndihmuar të moshuarit dhe ata që nuk dinë shkrim lexim apo që kanë probleme me të pamur, ka filluar të rritet tej mase, ndonëse nevojat për këtë mënyrë votimi do të duhej të zvogëloheshin.

Votimi me asistencë lejon që një person të ndihmojë një të moshuar vetëm një herë, ndërsa kjo praktikë disa herë është vërejtur të mos jetë respektuar. Në zgjedhjet e vitit 2013, tek rivotimet në Partesh, edhe pse një numër i konsiderueshëm i votimit me asistencë është evidentuar në librin përkatës, në shumicën absolute të rasteve në kabinën e votimit ka shkuar vetëm asistuesi, përderisa personi për të cilin votohej qëndronte në hyrje të vendvotimit.

Shqetësuese për Demokracinë në Veprim mbetet fakti që Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ), nuk i ka audituar librat e votuesve për të parë se në çfarë mënyre është regjistruar votimi me asistencë, ashtu siç kërkohet ligjrisht, dhe nëse një person është nënshkruar më shumë se një herë për votim me asistencë. Një veprim i tillë përbën shkelje ligjore dhe përgjegjësia bie te Këshilli i

Vendvotimit. Demokracia në Veprim edhe në raportin e vëzhgimit pas zgjedhjeve lokale të 2013-s, ka rekomanduar KQZ-në, që komisionarët të mos lëshojnë pe te votimi me asistencë, i cili në aspektin ligjor është rregulluar qartë dhe sanksionon mundësinë që një person të asistojë më shumë se një votues, siç ka ndodhur në disa raste<sup>6</sup>.”

VOTUES ME ASISTENCË

40.561

Votues me  
asistencë

Në këtë proces zgjedhor janë raportuar 40,561 raste të votimit me asistencë në 2377 vendvotime në Kosovë. Kjo përbën diku 5.6% të të gjithë votuesve që kanë votuar me asistencë, apo çdo i njëzeti votues. Komunat me numër të konsiderueshëm të votimeve me asistencë kanë qenë: Prizreni, Rahoveci, Podujeva, Peja, Glogoci dhe Lipjani. Në Mamushë, në shkollën fillore “*Haxhi Ymer Lutfiu*”, votimet me asistencë nuk janë shënuar në libër. Në vendvotimin e fshatit *Babush* të komunës së Lipjanit përpos që ka patur numër të konsiderueshëm të votimeve me asistencë është raportuar edhe një rast kur e bija ka asistuar nënën. Ajo, në proces është lejuar të flasë për partinë e preferuar dhe ka fotografuar votën. Numër të madh të votimeve me asistencë ka patur edhe në Sh.F. “*Migjeni*” në Obiliq, si dhe atë “*Kadri Zeka*” në Kaçanik.

### Fotografimi i fletëvotimeve

Në prag të procesit zgjedhor të 2013-së, KQZ-ja, me iniciativën e anëtarit të LDK-së në këtë institucion, mori vendim që të ndalojë fotografimin e fletëvotimit gjatë kohës së votimit. Ky vendim ishte marrë me qëllim të parandalimit të blerjes së votës. Megjithatë, interpretimi i PZAP-it, në procesin zgjedhor të 2013-s, sipas të cilit ka përjashtime nga ky rregull shkaktoi konfuzion në mesin e komisionerëve. Prandaj, kjo çështje duhet të rregullohet nga Kuvendi i Kosovës dhe të pasohet me udhëzime të qarta për zbatim.

Përpjekjet e KVV-ve për të zbatuar këtë vendim të KQZ-së, shkaktuan tensione në procesin e votimit dhe prishën qetësinë e procesit.


<sup>6</sup> Demokracia në Veprim. *Nuk ka zgjedhje të lira pa qëllime të mira: Raporti I Vëzhgimit të Zgjedhjeve Lokale 2013*. Shkurt, 2014.

Gjate vëzhgimit, në ditën e zgjedhjeve vëzhguesit e DnV-së, kanë evidentuar 33 raste kur është fotografuar vota ose është tentuar të fotografohet. Në Gjakovë, në objektin e vjetër të shkollës “Mustafa Bakija”, në vendvotimin 09R, një person ka tentuar që ta fotografoj votën, mirëpo është ndaluar nga komisionet. Poashtu në shkollën “Nexhmedin Nixha”, në vendvotimin 05D, është tentuar të fotografohet vota, mirëpo personi është ndaluar. Në Kamenicë, në shkollën “Skënderbeu”, në vendvotimin 01R, janë raportuar dy raste kur vota është fotografuar. Në Lipjan, në shkollën “Ernest Koliqi”, në vendvotimin 04R është fotografuar vota nga një person, teksa , në vendvotimin 03R është raportuar një fotografim të votës. Në Malishevë, në shkollën “Gjergj Fishta”, në vendvotimin 01R, po ashtu është bërë fotografimi i votës nga një person.

### Incidentet në procesin zgjedhor

Gjersa procesi i votimit në përgjithësi është zhvilluar qetë, imazhi i tij është cenuar nga disa incidente të izoluar. Disa të tilla janë manifestuar me kërcënime, kurse pjesa tjetër me probleme pas mbylljes së vendvotimeve.

Në përgjithësi, u shënuan 11 raste që u konsideruan si “kërcënime” apo “incidente” nga vëzhguesit e DnV-së në 2.377 vendvotimet. Në 8, pati ndërhyrje të personave të paautorizuar në vendvotime, kurse në 11 raste, mbyllje të përkohshme të vendvotimeve.



Vëzhguesit e DnV-së kanë evidentuar kërcënime në Skenderaj, në shkollën “Abedin Rexha”, në vendvotimin 01R, ku është kërcënuar kryesuesi i



vendvotimit. Në Lipjan, në shkollën “Ernest Koliqi”, në vendvotimin 03R, ka pasur një kërcënim dhe fyerje ndaj kryesuesit nga persona të njëjës prej partive politike.

Në mesin e incidenteve që janë evidentuar nga vëzhguesit e DnV-së, ka qenë rasti në Glllogoc në shkollën “Fazli Grajçevci”, në vendvotimin 01D, ku gjatë procesit të votimit ka pasur një keqkuptim në mes të kryesuesit dhe njërit nga komisioneret, të cilët janë grindur dhe fyer reciprokisht. Me këtë rast komisioneri lëshoi vendvotimin për një kohe të caktuar për t`u kthyer më vonë.

Në shkollën “Zekeria Rexha”, në vendvotimin 10R, në Gjakovë një vëzhguese nga një subjekt politik, ka evidentuar në një letër mbiemrat e personave nga lista e votuesve. Në Podujevë, në shkollën “Luigj Gurakuqi”, në vendvotimin 01R, një person kërkoi asistencë nga i biri, mirëpo për mungesë të letërnjoftimit, ajo nuk u lejua ta ndihmoj votuesin. Kjo revoltoi votuesin, i cili grisi fletëvotimin dhe ofendoi personat prezent. Në Prishtinë, në shkollën “Zenel Hajdini”, në vendvotimin 04R, ka pasur përleshje mes koordinatorëve. Njëri prej tyre ka ndërhyrë në një klasë tjetër, ndërkohë që është dashur intervenimi i policisë. Në Glllogoc, në shkollën fillore “Dëshmorët e Drenicës”, në vendvotimin 02D, gjatë numërimit të votave është vërejtur se një person i paautorizuar, që pretendonte se ishte vëzhgues (ndonëse emri i tij nuk figuronte në listë), është larguar nga vendvotimi pas intervenimit të policisë. Në gjimnazin “Sami Frashëri”, në Prishtinë, në vendvotimin 05R, gjatë procesit të votimit një person ka vërejtur se emri i familjarit të vdekur figuronte në listën e votuesve. Ai ka marrë dhunshëm librin e nënshkrimeve dhe e ka fshirë emrin e të afërmit të tij nga lista, duke fyer personelin prezent. Gjithashtu, në Kaçanik në shkollën “Emin Duraku”, një votues ka vërejtur emrin e babait të vdekur, ndaj në shenjë revolte ka fyer personelin zgjedhor dhe ka shlyer nga lista emrin e të atit.

Në shkollën “Kadri Beba”, në vendvotimin 01R, në Lipjan vëzhguesit e një subjekti politik kanë penguar tërë kohën komisionarët në punën e tyre. Në Malisheve, në shkollën “Hilmi Hoti”, në vendvotimin 04D, gjatë numërimit të votave është hasur në manipulim të numrit të fletëvotimeve. Në Kaçanik, në shkollën “Nazmi Osmani”, në vendvotimin 02D, është regjistruar një fjalosje ndërmjet një personi dhe koordinatorit. Sherri ka nisur ku vajza e tij nuk është lejuar të votojë me letërnjoftim të skaduar dhe dëmtuar.

Në shkollën “Fahri Hoxha”, në vendvotimin 02D, në Gjakovë, një person ka ushtruar ndikimin te gruaja e tij gjatë procesit të votimit. Kur komisionarët ia kanë tërhequr vërejtjen, ai ka fyer personelin zgjedhor. Konflikte dhe mosmarrëveshje janë raportuar në Podujevë në shkollën e mesme ekonomike, në vendvotimin 05R, ku pati mosmarrëveshje ndërmjet komisionerëve të qendrës së votimit dhe mbikëqyrësve. Në Pejë, në shkollën e mesme teknike, në vendvotimin 04R, ka ndodhur një mosmarrëveshje në mes të komisionerëve dhe kryesuesit të komisionit.

Në Prizren, në shkollën “*Motrat Qiriazhi*”, në vendvotimin 04R, ka pasur një konflikt në mes të komisionerëve dhe vëzhguesve. Ndërkaq në Prishtinë, në shkollën “*Asim Vokshi*”, një anëtar i një partie politike ka pasur konflikt me kryesuesin.

## Sfidat e administrimit

### Personat e vdekur në Listë

Problemet me Listë të votuesve dhe prezenca e emrave të personave të vdekur në listë u raportuan edhe në këtë proces zgjedhor. Megjithë faktin se Lista e Votuesve në prag të procesit zgjedhor, u pastrua nga KQZ-ja, problemi mbetet tek auditimi i hollësishëm i Listës së Votuesve që gjithashtu është përgjegjësi e këtij institucioni. Kësaj radhe, në 5 vendvotime u raportua numër i konsiderueshëm i emrave të personave të vdekur në listë të votuesve. DnV-ja ka raportuar rastet konkrete të emrave të personave të vdekur në listë të votuesve në zgjedhjet lokale 2013. Në disa raste ka pasur edhe dyshime në disa vendvotime për prezencën e emrave të të vdekurve në listën votuese. Përfshirja e emrave të të vdekurve në listën e votuesve ka ndodhur në Pejë në shkollën “*Vaso Pashkë Shkodrani*”, në vendvotimin 02R. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në vendvotimin 03R të po kësaj shkolle. Në Gjakovë, në shkollën “*Hajdar Dushi*”, në vendvotimin 04R, një person është ankuar pasi që ka gjetur emrin e prindit të të vdekur në listën e votuesve. Njëjtë ka ndodhur edhe në Prishtinë, në Gjimnazin “*Sami Frashëri*”.

Në Kaçanik, në shkollën “*Emin Duraku*”, në vendvotimin 05R, një nga votuesit gjatë nënshkrimit në listën e votuesve, gjithashtu ka gjetur emrin e një familjari të vdekur. Në këtë kontekst, Lista e Votuesve duhet t`i nënshtrohet rishikimi të hollësishëm, nga i cili do të largohen nga ajo emrat e personave që tashmë nuk janë në jetë. Përpjekja e deritashme për pastrim të pjesërishtëm nuk ka dhënë efektin e duhur. KQZ-ja, ka nevojë që të rishikojë p-kodet dhe ud-kodet për caktimin e qendrës së votimit për votues. Në këtë mënyrë duhet ofrojë një mekanizëm që në Ditën e Zgjedhjeve, votuesit që dalin të votojnë në qendrën e votimit të gabuar, t`i korrigjojnë të dhënat mbi adresat aty për aty.

### Përpjekjet për votim të dyfishtë

Tendencat për manipulim të procesit votues, nëpërmjet votimit dy herë apo “votimit të dyfishtë”, është një anomali që ka përcjellur sërish procesin zgjedhor. Komisionerët janë trajnuar të parandalojnë këtë lloj veprimi, dhe procedura e votimit ka kontroll për t`i parandaluar këto veprime. Të shumtën e rasteve, komisionerët i kanë parandaluar këto përpjekje të keqbërësve, ndonëse pati përpjekje për ta dëmtuar procesin. në disa vendvotime.

Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për 82 raste të tentimit për votim të dyfishtë në 2.377 vendvotime në Kosovë. Ndërsa në zgjedhjet lokale të vitit 2013, vëzhguesit kishin raportuar 74 raste të tentimit për votim të dyfishtë.

Komunat me më së shumti raportime për tentim të votës të dyfishtë ishin: Skenderaj (11 raste), Prishtina (9 raste), Mitrovica e Veriut (8 raste), Peja (7 raste), Leposaviqi (6 raste), Mitrovica e Jugut (6 raste), Ferizaj (5 raste), Gillogovc, Istog dhe Zubin Patok (4 raste), Gjilan, Malishevë dhe Zveçan (2 raste), kurse në 12 komuna të tjera është evidentuar një rast për tentim të votimit të dyfishtë.

Në Fushë Kosovë, në shkollën fillore “Mihail Grameno”, në vendvotimin 09D, dy persona kanë tentuar të votojnë për herë të dytë, mirëpo pas kontrollit me llampë ata nuk janë lejuar të votojnë. Në Gjilan, në shkollën “Abaz Ajeti”, një person ka provuar të votojë për herë të dytë, por nuk është lejuar pasi që është vërejtur se i kishte gishtat e spërkatur me sprej. Po ashtu, në shkollën “Selami Hallaqi”, në vendvotimin 03R, dy persona kanë provuar të votojnë për herë të dytë, mirëpo pas kontrollimit me llampë janë refuzuar. Në Skenderaj, në shkollën “Pavarësia”, në vendvotimin 01D, ka pasur tentime të njëpasnjëshme për të votuar dy herë, mirëpo një veprim i tillë është nuk është lejuar nga anëtarët e KVV-së. Në shkollën fillore “Imer Krasniqi”, në vendvotimin 01R, në Malisheve, ka pasur raste kur kanë tentuar të votojnë për herë të dytë, mirëpo pas kontrollit të gishtave nuk është lejuar votimi i këtyre personave.


Në Mitrovicë, në shkollën “Shaban Idrizi”, në vendvotimin 03R, dy persona kanë tentuar të votojnë për herë të dytë, mirëpo nuk janë lejuar. Në Viti, në shkollën “Januz Zejnullahu”, në vendvotimin 01R, dy persona që tentuan të votojnë për herë të dytë, pas kontrollimit me llampë, nuk u lejuan të votojnë përsëri.

## Ankesat zgjedhore

Numri i ankesave në PZAP për zgjedhjet e përgjithshme 2014 ka qenë 154 (të publikuara në 111 vendime në uebfaqen e këtij institucioni). Më së shumti ankesa ka patur nga PDK-ja, gjithsej 51, e pasuar nga Lëvizja Vetëvendosje me 37 ankesa, pastaj LDK-ja me 23 ankesa, NISMA për Kosovën me 9 ankesa, PDS-ja me 7 ankesa, AKR-ja me 6 ankesa dhe AAK-ja me 4 ankesa.

85 ankesa janë bërë për propagandë politike mirëpo ka patur edhe , teksa 20 për manipulime, 21 për rezultatet e kandidatëve dhe 6 për incidente. Disa ankesa nga subjektet politike kanë qenë edhe për menaxhimin e zgjedhjeve. Në lidhje me trupat menaxhues kanë, janë deponuar 5 ankesa, 5 për mospërputhje të rezultateve dhe 3 për material sensitiv.

## LLOJET E ANKESAVE PZAP



Ankesat me serioze kanë qenë ato për manipulime. Nga 20 shosh, LDK-ja ka parashtruar 6 ankesa, AAK-ja 3, PDS 3, ndërkaq nga 1 ankesë kanë parashtruar: AKR-ja, LVV-ja, PDK-ja, PDP-ja, PREBK-ja, KNRP-ja dhe KTAP-ja.


Ndër këto ankesa, tri të PDS-së kanë qenë më tipike ngase kanë evidentuar fotokopjimin e fletëvotimeve, manipulimin e votave me postë nga jashtë dhe manipulim të votave më kusht në Zveçan. Bajram Rexhepi nga PDK-ja, ka pretenduar të jetë dëmtuar, ndaj nëpërmjet ankesës ka shfaqur bindjen e tij se votat nuk janë numëruar në mënyrë të drejtë dhe korrekte.. AKR-ja në ankesën e saj ka pretenduar se gjatë numërimit të votave me kusht është vërejtur se ka pasur manipulim dhe se fletëvotimet kanë qenë të plotësuara nga një person për vetëm një parti. Ankesa të njëjta kanë parashtruar edhe subjektet politike si NISMA, LDK, AAK, dhe LVV.

Subjektet politike kanë parashtruar ankesa edhe për incidente. Tri janë bërë nga LVV-ja, dy nga PDK-ja dhe një nga AKR-ja.

LVV-ja në ankesën e saj ka pretenduar se aktivisti dhe komisionari nga radhët e subjektit LVV gjatë ditës së zgjedhjeve është kërcënuar prej disa personave të panjohur përmes telefonit. Në ankesën e dytë, LVV-ja ka pretenduar se këshilltari i partisë NISMA, ka kërcënuar anëtarin e KKZ-së nga LVV-ja, Valon Nushi. Në ankesën e tretë, LVV-ja ka pretenduar se në ditën e zgjedhjeve një

individ që ishte mbështetës i LDK-së në shkollën e mesme “Gani Cervasha”, ka shitur vota në vlerë prej 10 euro. Në të njëjtin vend, një person i ka treguar votën që e kishte fotografuar personit në fjalë.

## NR. ANKESAVE NGA SUBJEKTET



Ndërsa, PDK-ja në ankesën e parë ka pretenduar se në shkollën fillore “Fadil Hisari”, në Prizren një person nga LDK-ja, i ka ofruar qytetarëve para në këmbim të votës. Në ankesën e dytë PDK-ja, ka pretenduar se aktivistë të LDK-së, kanë hyrë në mënyrë të paautorizuar në qendrën e votimit 0604C në fshatin Guraçok dhe kanë penguar votuesit. Më pas aty ka ndërhyrë Policia e Kosovës dhe Prokurori i Shtetit. Ndërsa, AKR-ja në ankesën e parashtruar, ka pretenduar se me datë 03.06.2014 është djegur posteri i kandidatit për kryetar të Mitrovicës afër lagjes “Kolonja” tek varrezat serbe.


## VII. Procesi i numërimit

### Periudha e numërimit të votave

Është e qartë që procesi i numërimit duhet të plotësojë pesë kritere: saktësinë e numërimit, transparencën, efikasitetin, mundësinë për rinumërim dhe përsëritje, si dhe mbrojtjen e fshehtësisë së votës. Misioni ynë vëzhgues në të gjitha qendrat e votimit në Kosovë është dëshmitar i faktit që procesi i numërimit ishte transparent, kishte hapësira për rinumërim dhe përsëritje, ndërkohë që fshehtësia e votës ishte e mbrojtur gjatë procesit të numërimit. Numërimi ishte i saktë për shumicën e vendvotimeve, megjithëse përcaktimi nëse një votë ishte e vlefshme aspo e pavlefshme ishte i diskutueshëm në disa

momente. Nëse shikohet saktësia në kuptim të precizitetit të numërimit të votave të pavlefshme, komisionerët e vendvotimeve në këtë rast mund të kishin performuar më mirë. Natyrisht, në disa momente vendimi për të deklaruar një votë si të pavlefshme është subjektiv, por për shkak se të gjithë komisionerët duhet të pajtohen, është shumë e vështirë të njihet një votë si e vlefshme përveç nëse votuesi ishte absolutisht i saktë.

Efikasiteti i votimit mund të përcaktohet nga periudha që ju desh një vendvotimi që të numërojë fletëvotimet e tij dhe të mbushë si duhet procesverbalin e numërimit. Numërimi filloi menjëherë pas orës 19:00 në 53.9% të vendvotimeve. Mirëpo, për shkak të pritjeve në radhë të disa vendvotimeve, në diku 39.4% të vendvotimeve numërimi filloi pas orës 20:00. Kurse në 50 vendvotime, apo 2.2% numërimi filloi tek pas orës 21:00.



### Pritjet në radhë

Shumica e votuesve zgjodhën të votojnë pasditen e 8 qershorit, , shkak i gjatësisë së ditës. Kësisoj, pritje në radhë për të votuar, në ora 19:00 u evidentuan në 159 vendvotime. Më së shumti pritje u raportuan në komunën e Prishtinës (35 vendvotime), pastaj në Komunën e Pejës (14 vendvotime), Mitrovicë, Prizren dhe Rahovec (12 vendvotime në secilën).

Legjislacioni në fuqi gjithashtu lejon që çdo anëtar i KVV-së të kundërshtojë rezultatet gjatë numërimit dhe opinionin kundërshtues duhet të shënohet në Librin e Votimit. Në përfundim të procesit zgjedhor dhe fillim të procesit të numërimit kishte edhe mospërputhje të numrit të fletëvotimeve që ishin dorëzuar në hapje të vendvotimit dhe atyre që u numëruan.

## PRITJET NË RADHË



	Vendvotime
Prishtinë	35
Pejë	14
Mitrovicë	12
Prizren	12
Rahovec	12
Vushtrri	10
Ferizaj	8
Gjilan	8
Gjakovë	7

Në Shtime, në shkollën “Abdullah Shabani”, në vendvotimin 01R, janë pranuar 550 fletvotime, kurse kur është hapur kutia e fletëvotimeve numri i tyre ka qenë 600. Në Gjilan, në shkollën “Thimi Mitko”, në vendvotimin 02R, dy fletëvotime nuk kanë qenë të vulosura nga KVV-ja. Në shkollën “Drenica”, në vendvotimin 03R në Skenderaj, gjatë numërimit të votave është vërejtur se ka pasur një nënshkrim më shumë se numrin e fletëvotimeve që gjendeshin në kuti. Në Shtime, në shkollën “Bajram Curri”, në vendvotimin 01R, ka pasur një fletëvotim më shumë se sa kishte nënshkrime në listën e votuesve. Në Klinë, në shkollën “Azem Bejta”, në vendvotimin 02R, ka pasur dy nënshkrime më shumë në listën e votuesve se sa fletëvotime. Në shkollën “Mazlum Këpuska”, në vendvotimin 02R në Gjakovë ka pasur një fletëvotim më shumë se sa nënshkrime në listën e votuesve, kurse në shkollën “Muharrem Shemsedini”, në vendvotimin 02D ka pasur një nënshkrim më tepër në listën e votuesve se sa fletëvotime.


### Mospajtimet gjatë numërimit

Janë evidentuar 41 raste kur mospajtimet në procesin e numërimit u shënuan në librin e votimit. Ndërsa 36 raste të këtyre dyshimeve të ngritura u cilësuan si të drejta nga vëzhguesit e Demokracisë në Veprim. Ky rrjet i OJQ-ve që ka për qëllim përmirësimin e procesit zgjedhor bënë thirrje që KQZ-ja të bashkëpunojë në shqyrtimin të kujdesshëm të këtyre ankesave dhe

### MOSPAJTIMET GJATË NUMËRIMIT



Vendimi mbi dyshimet në fletvotime i drejtë




Mospajtimet e shënuara në libër

mospajtimeve zgjedhore, në bashkëpunim me sektorin jo-qeveritar, në mënyrë që të nxirren mësim për trajnimin e komisionarëve dhe vëzhguesve zgjedhor në të ardhmen, por edhe me qëllim që të mënjanohej parregullsitë që mund të ndodhin gjatë procesit të numërimit.

## VIII. Dalja në votime

Dalja e votuesve në zgjedhjet e përgjithshme të 8 qershorit ishte mjaft e ulët. Në këto zgjedhje dolën diku rreth 77,474 votues më pak se në zgjedhjet lokale të organizuara vetëm shtatë muaj më herët. Në fakt, numri i votuesve në këto zgjedhje ishte më i ulët edhe se në zgjedhjet e viti 2010 ku kishte rreth 10% më pak votues me të drejtë vote. Kjo rënie në dalje të zgjedhjeve është më e madhja që nga viti 2007. Ndaj, mbetet shumë shqetësues ky nivel i daljes në zgjedhje përkundër faktit që këto zgjedhje u mbajtën në pranverë dhe nuk kishte mot të keq siç ishim mësuar të kemi në shumë nga proceset zgjedhore të mëhershme në Kosovë.




Komunat me daljen në zgjedhje më të ulët ishin: Mitrovica e Veriut (17.0%), Zveçan (22.2%), Leposaviq (25.5%), Dragash (33.3%) dhe Gjakovë (34.6%). Ndërsa komunat me daljen më të lartë ishin: Gllogoc (49.7%), Klllokot (49.1%), Prishtinë (48.9%), Partesh (48.8%) dhe Skenderaj (48.1%).

Pjesëmarrja në fund të procesit zgjedhor ishte rritur ndjeshëm. Orët e para të Ditës së Zgjedhjeve u karakterizuan me pjesëmarrje jashtëzakonisht të ulët, siç ishte rasti edhe në zgjedhjet e kaluara të cilat ka raportuar Demokracia në



Veprim. Vetëm 12.8% e votuesve dolën për të votuar para mesditës. Periudha më dinamike e votimit ishte në mes orës 15:00 dhe 19:00.




## Votat e pavlefshme

Përkundër faktit se kësaj radhe u shënua një përpjekje më e madhe për të edukuar votuesit për mënyrën e rregullt të plotësimit të fletëvotimeve, edhe ky proces u përçoll me numër të shumtë të votave të pavlefshme. Këto zgjedhje ishin të jashtëzakonshme dhe me fushatë më të shkurtër, mirëpo sistemi zgjedhor ishte i njëjtë si në vitin 2007 dhe 2010. Pra, zgjedhjet u mbajtën me lista të hapura, një votë për subjektin politik dhe deri në 5 përzgjedhje për kandidatët e atij subjekti politik. Megjithatë, niveli i votave të pavlefshme për këto zgjedhje ishte pothuajse identik me nivelin e votave të pavlefshme të vitit 2010.

Votuesit ushtrojnë të drejtën e tyre qytetare me bindjen se çdo votë e tyre do të numërohet. Megjithatë, nëse një votë shpallet e pavlefshme, kjo do të thotë se përzgjedhja e votuesit për liderët e preferuar nuk do të numërohet. Prandaj, ndër problemet kryesore edhe në këtë proces zgjedhor janë votat e pavlefshme.

Në këto zgjedhje u evidentuan 1.899 vota të dëmtuara, të cilat zakonisht janë ato vota të protestës- pakënaqësisë ndaj zhvillimeve politik edhe politikanëve të vendit në përgjithësi. Krahasuar me zgjedhjet lokale të organizuara shtatë muaj më herët apo me zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010, vërtete dyfishim i tyre.



Komuna e Ferizajt prinë bindshëm me numrin e votave të dëmtuara ku është shënuar dhjetëfishi i votave të dëmtuara në krahasim me zgjedhjet lokale. Ndërsa numri i votave të përgjithshme të pavlefshme në këto zgjedhje kap shifrën prej 4.2%, njëjtë sikurse në zgjedhjet e përgjithshme të kaluara në vitin 2010.

Komunat me nivelin më të lartë të votave të pavlefshme janë: Komuna e Hanit të Elezit (7.6%), Ranillugu (7.2%), Shtërpca (6.6%), Shtëmja (6.5%), Graçanica (6.1%), Parteshi (6.0%), Glllogoci (5.6%), dhe Kaçaniku (5.2%). Kurse komuna me *numrin* më të madh të votave të pavlefshme janë: Prishtina (2,521 vota), Prizreni (2,303 vota), Ferizaj (2,116 vota) dhe Podujeva (1,572 vota).

Me gjithë përpjekjet e KQZ-së që të ketë edukim më të shumtë të votuesve për mënyrën e votimit, vërehet se ka patur shumë pak efekt. Demokracia në Veprim beson se edukimi i votuesve do të duhej të bëhet pas një analize se ku është më e shprehur kjo nevojë, jo vetëm në cilat komuna, por edhe në cilat qendra të votimit.

## IX. Rekomandimet

Rekomandimet e poshtëshënuara rrjedhin nga analiza e ofruar më lart dhe nga përvoja që Demokracia në Veprim ka marrë duke vëzhguar dhe raportuar vazhdimisht mbi procesin zgjedhor në Kosovë. Secili rekomandim është i bazuar në një nga përfundimet që del nga raporti i sipërm.

### A. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

- Qasja ndaj azhurnimit të Listës së Votuesve duhet të ndryshojë ose të fillohen përgatitjet për regjistrim aktiv të votuesve. Kjo pasi që përpjekjet e deritashme nuk kanë funksionuar në masë të duhur. KQZ-ja ka nevojë të rishikoj sistemin e P-kodeve dhe UD-kodeve për përcaktimin e qendrës së votimit për votues. Gjithashtu duhet të ofrohet një mekanizëm për votuesit që nuk e gjejnë emrin në qendrën ku ata që vijnë për të votuar ditën e zgjedhjeve, në mënyrë që të dhënat të mund të i përmirësojnë në kohë reale. Auditimi i fletëvotimeve të pavlefshme duhet të bëhet edhe për këto zgjedhje sikurse për ato të vitit 2013, nga shkak se sërish ka numër të madh të votave të pavlefshme. Në raportin e kaluar ky numër ka rezultuar me 3.7% të votave, të cilat janë vlerësuar nga komisionarët si të pavlefshme e në fakt ishin të vlefshme;
- Fushata e informimit për votues ka qenë pa një target grup të qartë. Kjo fushatë duhet të bazohet në një anketë paraprake me votuesit dhe hulumtim të thuktë, i cili mund të targetoj dhe të i përshtatet grupeve që kanë nevojë më së shumti për ato informata, sikurse që janë votuesit e rinj dhe femrat. KQZ-ja duhet të përqendroj fushatën e informimit te mënyra e plotësimit të fletëvotimeve të zgjedhjeve, në mënyrë që të parandalohet niveli i lartë i votave të pavlefshme. Gjithashtu, kjo fushatë duhet të koncentrohet edhe te sensibilizimi i mekanizmave për ankesa dhe parashtrësia në mënyrë që qytetarët të jenë sa më të informuar për sigurimin e procesit zgjedhor të rregullt.
- Në periudhën paszgjedhore, KQZ-ja duhet të bëjë auditimin e librit të votuesve dhe ankesave të votuesve. Këto ankesa dhe komente duhet të reflektojnë në trajnimet që ky institucion organizon për komisionerët e këshillave të vendvotimeve. Bazuar në të dhënat e Demokracisë në Veprim “Votimi me Asistencë” është duke u keqpërdorë në vazhdimësi në shumë vendvotime. Andaj KQZ-ja, duhet të bëjë auditim të librit për votim me asistencë që të evidentojë këto probleme dhe të marrë masa ndaj atyre komisionerëve që nuk i kanë respektuar procedurat e votimit me asistencë;
- Shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga ana e KQZ-së nuk duhet të tejzgjatet. Vonesat e mëdha sjellin dyshime në procesin e numërimit si për subjektet, kandidatët dhe qytetarët e Kosovës.

- Komisionerët e Vendvotimeve duhet të trajnohen më mirë për të ngritur efikasitetin e procesit të numërimit, siç e parasheh legjislacioni në fuqi, të mënjanojen tejzgjatjet e procesit të numërimit deri në katër apo pesë orë siç ka ndodhur në gati gjysmën e vendvotimeve;

## B. Komisionet Komunale Zgjedhore

- Duhet të ketë takime formale, të rregullta që mbahen gjatë gjithë procesit zgjedhor në mënyrë që çështjet organizative të zgjedhjeve të diskutohen siç parashihet me ligj dhe vendimet të merren në formë zyrtare;
- KKZ-të duhet të jenë transparente ndaj publikut dhe vëzhguesve të organizatave joqeveritare, duke ofruar rendin e ditës të takimeve dhe vendimet. KKZ-të duhet të dalin në terren dy ditë para ditës së zgjedhjeve dhe t'i evidentojnë të gjitha materialet e fushatës (billborde dhe posterë), brenda diametrit 100 metra nga qendra e votimit dhe t'i përkujtojnë subjektet politike që t'i tërheqin materialet 24 orë përpara se të filloj procesi i votimit. Siç tregojnë të dhënat e DnV-së, gjatë ditës së zgjedhjeve, 4.5% e qendrave të votimit kanë pasur propagandë zgjedhore brenda diametrit prej 100 metrave;
- Të bëjnë përpjekje më të madhe për edukimit të votuesve dhe pastrimit të listës së votueseve, posaçërisht në periudhën kur nuk ka zgjedhje.

## C. Këshillat e Vendvotimeve

- Votimi me asistencë është i rregulluar me ligj, ndaj komisionerët nuk duhet të tolerojnë që një person të asistojë më shumë se një votues siç është toleruar në disa vendvotime, të përmendura në raportin e mësipërm;
- Komisionerët duhet të jenë shumë më vigjilent për parandalimin e votimit familjar pasi që një gjë e tillë vazhdon të cenoj fshehtësinë e votimit.
- Komisionerët gjatë gjithë procesit të votimit duhet të qëndrojnë në vendvotimet ku janë caktuar paraprakisht dhe mos të lëvizin vazhdimisht. Gjatë këtyre zgjedhjeve janë raportuar rastet kur në vendvotim mbesin nga 3 komisionerë dhe vëzhguesit marrin përsipër detyrat e komisionerëve.

## D. Subjektet politike

- Zyrtarët publik nuk duhet të përdorin resurset publike në fushatë zgjedhore pasi që ky veprim e shndërron fushatën në të pabarabartë dhe dëmton taksapaguesit kosovar;

- Të mos detyrohen shërbyesit civil që gjatë orarit të punës të bëhen pjesë e tubimeve të subjekteve politike;
- Të trajnohen edhe më komisionerët, të rritet cilësia e vetë komisionerëve. Në këtë aspekt duhet një angazhim i thellë i të gjithë akterëve, e sidomos partive politike të cilat janë ato që nominojnë anëtarët e tyre në KVV.
- Të bëhet përpjekje për të emëruar numër më të madh të femrave në Komisionet e Vendvotimeve pasi që niveli i tanishëm është shumë i ulët ndërsa përfaqësimi gjinor është i ulët sidomos në komuna të vogla;
- Të bëhen publike financat për fushatë elektorale;

## E. Mekanizmat e ankesave

- PZAP-ja duhet të informoj KQZ-në mbi rastet që presin vendimin e tyre, veçanërisht për rastet që mund të kenë ndikim në obligimet ligjore të KQZ-së, si finalizimi i Listës së Votuesve apo edhe rasteve që mund të ndikojnë në rezultatet finale të vendvotimeve. Duhet të ketë një mekanizëm të koordinimit gjatë procesit zgjedhor në mes të KQZ-së, PZAP-së dhe Gjykatës Supreme në mënyrë që të gjitha palët të jenë të informuara për punën e njëra-tjetrës gjatë procesit zgjedhor.

## F. Kuvendi i Kosovës

- Të shqyrtoj reformën zgjedhore, regjistrimin aktiv të votuesve në rast se KQZ-ja dhe MPB-ja nuk janë të afta të përmirësojnë më mënyrë rrënjësore Listën e Votuesve;
- Të parashoh përfshirjen gjinore në emërimin e anëtarëve të KVV-ve, pasi që, në masë të madhe gratë janë lënë jashtë trupave të administrimit të zgjedhjeve.
- Legjislatura e re e Kuvendit të Kosovës duhet të ketë në fokus të saj, reformën e mirëfilltë të legjislacionit zgjedhor, ku preken edhe elementet të rëndësishme të administrimit të procesit zgjedhor.